



# VËZHguesi



**-BIZNES-**



**KOALICIONI I  
BIZNESIT  
KUNDËR  
KORUPSIONIT  
KORÇË**



**-BIZNES-**

## NË KËTË NUMËR TË “VËZHguesIT” DO TË LEXONI:

**NJË TAKIM SHUMË I DOBISHËM**  
*-Qendra Tregtare “Pazari Korçë”-*



Faqe 2

**TAKIME TË KËSHILLIT TË IDEVE**



Faqe 3

## MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E KËSHILLIT TË IDEVE



Faqe 5

ARZH

TRAINIM

Biznes i Vogël

# NJË TAKIM SHUMË I DOBISHËM

## -Qendra Tregtare "Pazari Korçë"-

-Stafi i ARZH-së takohet dhe bisedon me subjektet e Biznesit të vogël në Qendrën tregtare "Pazari i Korçës", për zbatimin e ligjit Nr.9920, dt.19.05.2008-"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

\* \* \*

-Në zbatim të Projektit, ARZH organizoi një takim në ambjentet e Qendrës Tregtare "Pazari Korçë" me subjektet e Biznesit të vogël (2 milion-8 milion lek) në këtë qendër tregtare të rëndësishme të qytetit tonë.



-Takimin e çeli Znj.Kostanca Janaqi-Administratore e kësaj qendre tregtare, e cila foli për qëllimin e takimit dhe falenderoi përfaqësuesit e ARZH-për ndihmën e tyre në këtë proces në informimin dhe zbatimin e ligjit, në mënyrë që subjektet të jenë të përgatitur për Bilancin e 31 mars 2009.

-Drejtori i ARZH-

**Z.Aurel Grabocka**, zbërtheu ligjin dhe theksoi, se Projekti ynë është në krah dhe në ndihmë të Biznesit të vogël, për të bërë një tregti të kulturuar, në bazë të konkurrencës të ndershme, që presupozon zbatimin e ligjit, lufton

Znj.Lida Raci (kontable e miratuar) iu përgjigjet pyetjeve të të pranishmëve në takimin e organizuar nga ARZH-Koçë me subjektet e Biznesit të vogël, në Qendrën tregtare-Pazari Korçë

**-Pyetje:-**Në mungesën aktuale të "Arkave regjistruese", si mund të veprojmë?

**Përgjigje:-**Sipas udhezimit nr 24, dt 02.09.2008, ne zbatim të Ligjit nr 9920 dt 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", sipas Nenit 46 Pika 46.1.6, ne mungese te Arkave regjistruese leshohet Deftese Tatimore.

**Pyetje:-**Deklarata doganore, nga dogana njihet si futurë blerje?

**Përgjigje:-** Po.

**Pyetje:-**Sigurimet shoqërore njihen si shpenzime?

**Përgjigje:-** Po.

**Pyetje:-**Cili është numri minimum i fuqisë punëtore që duhet të ketë të punësuar Biznesi i vogël (2 milion-8 milion lek)?

**Përgjigje:-** Ne baze te VKM Nr 1251, dt 10.09.2008 ky numur varet nga :-

a-Lloji i biznesit.

b-Niveli i te ardhurave bruto vjetore.

**Pyetje:-**Bilanci që duhet dorëzuar deri më 31 mars 2009, ku ti gjejmë faturat të cilat nuk na janë dhënë deri tani nga Biznesi i madh?

**Përgjigje:-** Duhet te jeni te vendosur dhe kembengules per te mos blere mall pa fature.

**Pyetje:-**A do ta zgjidhë Bashkia problemin e konkurrencës së pandershme, që bëhet jashtë Qendrës Tregtare-Pazari i Korçës, nga disa tregtarë të "tezgave", të pa licensuar?

**Përgjigje:-**Ky problem eshte trajtuar ne Programin e Punes per bashkepunimin e Shoqates se Biznesit te Vogel me Bashkine Korce.

**Pyetje:-**Mos duhet që Drejtoria e Tatim Taksave të ketë parasys që ky vit është eksperimental dhe ne na mungon dokumentacioni sipas ligjit për të llogaritur tatimin 10 % mbi fitimin. Ajo nuk duhet të tregohet strikt, por të gjejë modulacione të përshtatshme, për të prevenuar korrupsionin, që bëhet nga kjo mungesë e pjesshme e dokumentacionit?

**Përgjigje:-** Ligji ka hyre ne fuqi me dt 01.01.2008 dhe do te zbatohet. Ky ligj eshte ne interes te biznesit.

**Pyetje:-**Sa duhet të jetë tatimi 10 % për 40 milion xhiro?

**Përgjigje:-**Tatimi fitimi 10% nuk llogaritet mbi xhiron, por mbi fitimin.

**Pyetje:-**Kur Bashkia do të krijojë dhe 3-4 pika të tjera shitje me "tezga", por të licensuara dhe pazari të ç'lirohet nga tezgat që janë sot?

**Përgjigje:-**Ky problem do te zgjidhet nga bashkepunimi Shoqate Biznes i Vogel - Bashkia Korce.

**Pyetje:-**Pse nuk na njihet licenca si Biznes i vogël (2 milion-8 milion) për tu pajisur me viza nga Konsullata?

**Përgjigje:-** Licenca e biznesit të Vogël për t'u pajisur me viza për qëllime biznesi njihet nga Konsullata Greke, por kjo licencë duhet të plotësohet me gjithë dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim (fatura blerje,shitje etj)

**Pyetje:-**Kur Bashkia do të verë oraret për dyqanet e Biznesit të vogël?

**Përgjigje:-** Ky problem do të zgjidhet nga bashkëpunimi Shoqatë Biznes i Vogël me Bashkinë.

korrupsionin, rit të ardhurat dhe fuqizon subjektet e biznesit të vogël.

-Znj.Lida Raci-(kontable e miratuar), shpjegoi mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit-faturat e blerjes, e shitjes-regjistrat-bilancin, e tjera.

-Pjesmarësit në takim, diskutuan rreth problemeve që lidheshin me mbajtjen e dokumentacionit, vështirësitë që ata hasin gjatë furnizimit me mall, për mospajisjen me fatura nga Biznesi i madh, për të cilën duhet të ndërhyjë



shteti për ti detyruar ata që të japin mall me shumicë, duke zbatuar rregullat ligjore. Gjithashtu ata shprehën dëshirën për tu takuar me Kryetarin e Bashkisë **Z.Niko Peleshi**, për të biseduar për konkurrencën e pandershme, e të tjera.

-Të pranishmit bënë dhe pyetje, të cilave iu përgjigj Znj.Lida Raci. Takimi ishte shumë i frutshëm dhe të pranishmit falenderuan ARZH-në, e cila po kontribon konkretisht në ndihmën që po i jep Biznesit të vogël dhe nëpërmjet asistencës financiare, kur ata e kërkojnë.

**Vehbi Furxhi**

## AKTIVITETE TË KËSHILLIT TË IDEVE

Në vazhdim të mbledhjes së parë të Këshillit të ideve u organizuan takime të veçanta me kërkesën e nëngrupeve të sportit dhe të biznesit (10-15 Nëntor).

Në këto takime u diskutuan probleme të përgjithshme dhe të veçanta, mundësitë për projekte zhvillimi dhe zgjidhje të problemeve të evidentuara.

Të dy n/grupet kërkuan takime të veçanta me kryetarin e Bashkisë Korçë, **z. Niko Peleshi**.

Takimet janë vetëm fillimi i organizimit të punës për zgjidhjen e problemeve të sportit dhe të biznesit të vogël. Këshilli i ideve po tregon se ka mundësi për të gjeneruar energji pozitive në drejtim të zgjidhjes së problemeve qytetare.

### Takimi i n/grupit të sportit me z. Niko Peleshi, Kryetar i Bashkisë Korçë

Në takimin me përfaqësues të n/grupit të sportit morrën pjesë: **z. Isuf Salicë; z. Kristaq Titili; z. Arjan Kostani; z. Romeo Xinxifi**.

-Në takim janë ngritur probleme të veçanta si më poshtë:

-Gjatë viteve 90 dhe më vonë është shkatërruar bërthama shkencore e cila ka qenë në aktivitet të plotë për një periudhë të gjatë kohe.

-Trainerët kanë nevojë për training dhe ngritje profesionale të vazhdueshme.

-Mungon konkursi në përzgjedhjen e stafëve drejtuese, por edhe të trainerëve. Kjo ka sjellë një pëshëjllim të madh si dhe ulje të cilësisë të manaxhimit të klubeve, apo të rezultateve cilësore nga sportistët.

-Mungon përgatitja e përditshme profesionale nga ana e trainerëve të klubeve të sportit.

-Nuk ka planifikim të stërvitjeve dhe të ngarkesave.

-Nuk ka motivim të specialistëve.

-Punohet shumë pak me fëmijët dhe nuk kemi epike zinxhir.

-Mungon bashkëpunimi i specialistëve dhe i mjekut për të arritur rezultate cilësore dhe për të përgatitur kampionë.



-Probleme me mentalitetin. Nuk arrijmë të ngrihem mbi interesat personale, aq më tepër pengojmë njeri-tjetrin.

**Për të eliminuar dobësitë dhe problemet që vërehen n/grupi i sportit mendon se duhet të merren masat e mëposhtme:**

- Të njihet realiteti në mënyrë sa më të pastër dhe të drejtpërdrejtë.

-Të bëhet një analizë e hollësishe e gjendjes dhe më pas

të diskutohet për problemet dhe eliminimin e këtyre problemeve.

- Të përgatitet një strategji e veçantë për zhvillimin e sportit.

- Shoqëria civile të ketë rol aktiv në përgatitjen e strategjisë së sportit.

**Z.Niko Peleshi ka mbështetur dhe përshëndetur anëtarët e n/grupit të sportit dhe ka dhënë sugjerimet e tij për ecurinë e këtij procesi. Ai mendon se për të zgjidhur problemet e lartpërmendura është e nevojshme:**

-Të krijohet një këshill teknik i cili do të supervizojë dhe do të ndjekë objektivat. Këshilli teknik të profilizohet me nënkomitetet.

-Të përgatitet strategjia për zhvillimin e sportit.

-Të gjendet një formulë që të ketë bashkëpunim midis specialistëve.

- Të jepen forma për integrimin e specialistëve.

- Akademia sportive të bëhet realitet.

-Po ashtu mendohet, se organizimi i një kampionati ballkanik për të rinjtë do të sjellë zhvillime në gjendjen e sportit.

-Në përfundim është vendosur që pasi të ketë konsultime do të vendoset për krijimin e grupit të punës, i cili do të kryejë analizën e gjendjes dhe do të përgatisë strategjinë për zhvillimin e sportit.

-Takimi ka vazhduar me prezantimin e projektit të qendrës sportive "Sport Planet" të paraqitur në EXPO REAL. Projekti u pëlqye në mënyrë të veçantë dhe pjesëmarrësit shprehën mbështetjen e tyre për realizimin e këtij projekti madhor.

## TAKIME TË N/GRUPIT TË BIZNESIT

-N/grupi i biznesit ka kërkuar që të kryhet një takim konfidencial i kryetarin të shoqatës së biznesit të vogël **z. Albert Nasto** me kryetarin e Bashkisë Korçë, **z. Niko Peleshi**. -Në takim u kërkuar që të bisedohej në mënyrë të hapur për problemet e biznesit të vogël si dhe për luftën ndaj informalitetit dhe konkurrencës së pandershme.

-Gjatë takimit **z. Albert Nasto** prezantoi të gjitha problemet e biznesit të vogël të qytetit lidhur kjo edhe me gjendjen në pazarin industrial, merkato dhe në tregun me shumicë. Ai ka evidentuar arritjet në manaxhimin e tregut të shumicës si dhe në luftën ndaj informalitetit. Por gjithashtu ka kërkuar punë më të thelluar të policisë bashkiake kundër informalitetit si dhe pajisjen me mjete dhe me kompetenca më të gjera të drejtorisë së të ardhurave dhe policisë bashkiake për liçensimin e bizneseve të palicensuara. Sigurisht situata e vështirë e tregut dhe e ecures së biznesit e bën më urgjente ndërhyrjen në tregun e palicensuar për të sjellë liçensimin e subjekteve pa liçensë dhe konkurrencë të mbështetur në të dhënat që do të vetëdeklarohet biznesi për çdo biznes për sa ata paguajnë taksa, por edhe vogël kërkon barazi horizontale përballë taksave. Kjo presupozon që biznese me të ardhura

Po ashtu kërkohet drejtësia vertikale e cila më shumë. -Z. Peleshi e ka quajtur shumë të vazhdohet pandërprerë lufta kundër informalitetit, shoqata e biznesit të vogël dhe dëshiron që të ketë shoqate për të kuptuar hallet e tyre dhe për të anëtarëve të shoqatës (firmosur nga 1500 sipërmarrës) në mbrëmje. Po ashtu kërkohet që me një plan të ketë ditën e dielë pushim. Një ditë në javë Merkato se i merr në konsideratë propozimet dhe do të ketë të bërë të mundur realizimin e këtij propozimi. -Po ashtu Shoqata e Biznesit të vogël ka kërkuar prodhimin e një shenje të veçantë me elementë sigurie, e cila do të vendoset nga bizneset në vitrinën e ambientit të shërbimit. Kjo shenje e veçantë do të japë mundësinë të gjithë qytetarëve që të identifikojnë në qoftë se biznesi është i liçensuar apo jo. Kërkohej që kjo shenje e veçantë të prodhohet gjatë tremujorit të parë të v. 2009 dhe të shpërndahet për bizneset e liçensuara deri në fund të muajit Mars 2009. -Z. Niko Peleshi e ka pëlqyer propozimin dhe në muajt në vazhdim do të punohet për përgatitjen e kësaj shenje me elemente sigurie si dhe për shpërndarjen e saj në momentin që biznesi i vogël do të paguajë taksën lokale. Në fund të takimit është vendosur që të ketë takime të veçanta me biznesin e vogël të ndarë sipas profileve. Z. Albert Nasto e ka falenderuar kryetarin e Bashkisë për mbështetjen dhe ka shprehur besimin e biznesit të vogël në zgjidhjen e problemeve dhe luftën ndaj informalitetit.



presupozon që ata që fitojnë më shumë të paguajnë rëndësishëm takimin dhe ka premtuar që do të Ai kërkon informacion të vazhdueshëm nga kontakte të vazhdueshme me anëtarët e kësaj zgjidhur ato. -Në vazhdim u bisedua për propozimin e për zgjatjen e orarit të shërbimit ndaj qytetarëve caktuar duke mos penguar shërbimin, biznesi i vogël të dhe Tregu Industrial të jenë pushim. -Z. Peleshi premtoi, konsultime midis specialistëve dhe shoqatës për

**MARIELA TRAKO  
VIOLA MANO**

Informim

-Në ndihmë të Biznesit të vogël-

Transparencë

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve-Legjislacioni tatimor 2008  
Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.1251 datë 10.09.2008

## VENDIM

Nr.1251, datë 10.9.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT REFERUES TË TË PUNËSUARVE, PËR EFEKT TË PAGIMIT TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE, SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, NË DISA VEPRIMTARI KRYESORE, PËR TATIMPAGUESIT E REGJISTRUAR NË BIZNESIN E VOGËL**

*Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave*

## VENDOSI:

1.Kur administrata tatimore vëren se numri i të punësuarve, të deklaruar nga tatimpaguesit e regjistruar në biznesin e vogël, për efekt të pagimit të kontributit të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, nuk është real dhe nuk i përgjigjet vlerës së tregut për shërbimet e punësimin, ajo ka autoritetin të bëjë rivlerësim, sipas llojit të veprimtarive dhe vëllimit të të ardhurave vjetore. Numri minimal referues i të punësuarve, përfshirë edhe të vetëpunësuarit, jepet në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2.Subjektet e regjistruara në biznesin e vogël janë të detyruara të deklarojnë, në organet tatimore, të gjithë personat, që punojnë në biznesin e tyre, përfshirë veten dhe anëtarët e papaguar të familjes, me të cilët punon e bashkëjeton ligjërisht, si dhe të llogarisin e paguajnë kontributet, sipas përcaktimeve të akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi.

3.Punonjësit e autorizuar të administratës tatimore, gjatë kryerjes së verifikimeve apo kontroleve, shqyrtojnë numrin e punonjësve të deklaruar nga subjekti, si dhe kryejnë rivlerësimet e nevojshme, në bazë të llojit të veprimtarisë, vëllimit të punës, vendeve të punës e regjimit të punës, etj. në raport me numrin referues të punonjësve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

4.Në rast kundërshtimi ndaj vlerësimeve të administratës tatimore, subjekti duhet të provojë se vlerësimi është i gabuar, të argumentojë e vërtetojë saktësinë e deklarimeve të bëra nga ana e tij, si dhe të ndjekë procedurat e ankimit. Në këto raste, ministri i Financave autorizohet të përcaktojë procedurën administrative të shqyrtimit të ankesave, dhe mënyrën e dhënies së përgjigjes. Në rast të kundërshtimeve, subjekti ka të drejtë të ndjekë procedurën e ankimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

5.Subjektet, që kryejnë më shumë se një veprimtari ekonomike, për efekt të zbatimit të këtij vendimi, klasifikohen sipas veprimtarisë kryesore. Veprimtaria kryesore ekonomike përcaktohet në bazë të përquajtës më të madhe të xhiros, të deklaruar nga subjekti dhe të saktësuar nga organet tatimore, bazuar në kriteret e përcaktuara në "Nomenklaturën e veprimtarive ekonomike", botim i Institutit të Statistikës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve mbahen parasysh edhe lloji i veprimtarive, që zhvillohen.

6.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

-Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Nr	Lloji i veprimtarisë	2000-3.000	3.000-5.000	5.000-7.000	7.000-8.000
30	Shkollë	2	2	3	3
31	Konshite	2	2	3	3
32	Konshite të tjerë	2	2	3	3
33	Kuzina	2	2	3	3
34	Kuzina të tjerë	2	2	3	3
35	Klinika mjekësore	3	3	4	5
36	Laborator analizash mjekësore	3	3	4	5
37	Klinika dentare	2	2	3	3
38	Klinika dentare + laboratore	3	3	4	5
39	Laboratore dentare	2	2	3	3
40	Qendra estetike, sallone bukurie	2	2	3	3
41	Qendra fitnesi, terapie, dietologjike etj.	3	3	4	5
42	Shtëpi botuese	2	2	3	3
43	Shtypshkronja	4	4	5	6
44	Shtypshkronja + aktivitet shitje	4	4	5	6
45	Studio projektimi	4	4	5	5
46	Studio arti, pikturë etj	3	3	4	4
47	Studio konsulence e ekspertize teknike, ligjore, financiare etj	4	4	5	5
48	Agjenci shërbimesh të ndryshme	1	1	2	3
49	Agjenci shërbimesh funerali	4	4	5	6
50	Prodhime material ndërtimi	3	3	4	5
51	Prodhime korniza, riparime	2	2	3	4
52	Prodhime kozmetike	2	2	3	4
53	Prodhime të pijeve freskuese	2	2	3	4
54	Prodhime mermeri	3	3	4	5
55	Lavazhe	2	2	3	4
56	Transport udhëtarësh me autobus	2	2	3	4
57	Transport udhëtarësh me furgon	1	1	2	2
58	Transport udhëtarësh me taksì	1	1	2	2
59	Transport mallrash	2	2	3	3

Nr	Lloji i veprimtarisë	Të punësuar gjithsej sipas nivelit të të ardhurave bruto vjetor për bazën e taksës (në mijë lekë)			
		2.000-3.000	3.000-5.000	5.000-7.000	7.000-8.000
1	Hotele	3	4	5	5
2	Motele	2	3	4	5
3	Hotel-restorant/Motel-restorant	5	5	6	6
4	Bar-Restorant	3	4	5	5
5	Restorant	3	3	4	5
6	Bar-kafe	2	2	3	4
7	Bar kafe-lojëra, internet etj.	3	3	4	5
8	Minimarkete	2	2	3	4
9	Prodhime brumi	2	3	4	5
10	Prodhime buke	2	3	4	4
11	Prodhime brumi dhe tregtim	3	4	4	5
12	Prodhime pasticerie	1	2	2	3
13	Hamburger-doner-etj.	2	2	3	4
14	Hamburger, doner, akulllore	2	2	3	5
15	Picëri	2	2	3	4
16	Picëri, doner, hamburger, akulllore etj.	2	3	3	4
17	Birrari-qebapto	2	2	3	4
18	Punime duralumini	3	3	4	5
19	Punime karpentierie	3	3	4	5
20	Hekurkthyes, prodhim, montim kangjella etj.	3	3	4	5
21	Punime suvatimi + lyerje	3	3	4	5
22	Punime të ndryshme ndërtimi (riparime ndërtimi, hidro, elektrike etj.)	3	3	4	5
23	Reparte riparimesh, aparate elektrike, elektronike	2	2	3	4
24	Punime druri e mobilje	3	4	4	5
25	Punime dekor, reklama	2	3	3	4
26	Punime tapicerie	3	3	4	5
27	Autoservis	2	3	4	5
28	Autoservis + shitje pjesë ndërtimi	3	3	4	5
29	Çmontim makina dhe shitje p/ndërtimi të përdorura	2	3	4	4

Tabela e numrit minimal referues të të punësuarve, përfshirë edhe të vetëpunësuarit, për disa veprimtari të subjekteve të biznesit të vogël, sipas nivelit të të ardhurave bruto vjetore për bazën e taksës.

-ARZH-Korçë-

- Trasparencë-

-Kronika e kohës:  
26 nëntor 2008

## MBLEDHJA E PËRGGJITHSHME E KËSHILLIT TË IDEVE

-Në ambientet e ARZH-së u zhvillua:-Mbledhja e përgjithshme e Këshillit të Ideve.

-Merrnin pjesë antarë të Këshillit dhe të ftuar të tjerë.  
-Mbledhjen e çeli Drejtori i ARZH-së Korçë Z.Aurel Grabocka, i cili u praqiti të pranishmëve rendin e ditës.

1.Informim mbi veprimtarinë e zhvilluar nga Këshilli i Ideve midis dy takimeve.

2.Ide dhe propozime për veprimtari të tjera në kontekstin e një problematike progresive e funksionale, të materializuar në ide projektsh.

3.Çështje organizative për funksionimin e drejtimit të Këshillit të Ideve në rotacion, si një metodë efikase e demokratike.

për të evidentuar të licencuarit, nga informalët, për të cilët media e shkruar dhe ajo radio-televizive private dhe ajo publike do të kenë një fushë konkrete dhe publistike me bukë edhe në luftën kundër korrupsionit.

Z.Isuf Salije:-Sporti duhet të ngrihet në ato parametra që kërkon koha. Korça ka specialistë për ta bërë atë, por ata duhen afruar, dëgjuar dhe vënë në jetë propozimet e tyre nga Bashkia.

Në 2009 do të festohet 100 vjetori i Shoqërisë sportive "Vllazëria", duhet të përgatitemi mirë.

-Nën grupi i sportit ku unë bëj pjesë u takua me Z.Niko Peleshin dhe shkëmbyen mendime për zhvillimin me sukses të sportit, ngritjen e një grupi konsultativ për hartimin e projekteve afat-

është Korça. Ai theksoi se përdorimi i drogës nga të rinjtë po bëhet shqetësues prandaj duhet të japim ide për projekte, për parandalimin e këtij fenomeni negativ në qytetin tonë që është në rritje dhe një e keqe e madhe për brezin e ri, sidomos të rinisë shkollore.

-Gjithashtu mendime dhanë dhe Z.Vladimir Cepa, Diana Naumi, Vangjush Tërrova, të cilët ngritën probleme të Biznesit të vogël, kulturës së tregtimit, stimulimin e punëve artizanale, si ato të qëndisjes dhe të qilimave, etj.

-Nga përfaqësuesit e medias u soll zëri i një elite studentësh që kanë mbaruar këtë vit Universitetin "Fan S.Noli" me rezultate shumë të mira, të cilët ngrënë problemin e mos stimulimit nga rektorati të



4.Mendime të lira që nxisin iniciativën për vetveprim gjithëpërfshirje dhe partneritet frutdhënës.

\*\*\*

Përfaqësueset e Bashkisë Korçë Znj.Vilma Petro, Eriola Stirmolli, Mariela Simo, theksuan midis të tjerave rëndësinë dhe vlerën e Këshillit të Ideve, partneritetin e suksesshëm të Bashkisë me ARZH-në, si dhe fillimin e mbarë të punës të Këshillit të Ideve dhe nëngrupeve, si ai i Biznesit të vogël dhe sportit. Gjithashtu ato folën për projektet 82 % e të cilave janë realizuar, bashkëpunimin me SOROS-in, USAID-in, zyrën e punës, etj. Ato treguan për Guidën e biznesit korçar që do të nxjerrë Bashkia e Korçës.

Në veçanti ato informuan Këshillin e Ideve për Buletinin statistikor vjetor, i cili do të jetë një mjet publikimi informativ me të dhëna statistikore-tabela-diagrama-foto, mbi biznesin –projektet-demografinë, të dhëna interesante për qytetin e Korçës-oferta për të rinjtë, për grande fituese, për hapje biznesesh të reja, etj.

-Z.Albert Nasto-(Kryetar i Shoqatës së Biznesit të Vogël) u përqëndrua tek takimi i suksesshëm me kryetarin e Bashkisë Z.Niko Peleshi, dialogimin me të për luftën kundër informalitetit, konkurrencën e pandershme, oraret, mbi bashkëveprimin me policinë bashkiake, etj.

-Problemet në merkato-tregu industrial, "pullat e sigurisë licensore", të cilat duhet të afishohen në çdo njësi tregtare në qytetin e Korçës, si një mjet simbol

shkurtra, afatgjata dhe afatmesme, ku do të përfshihemi edhe ne për ti dhënë rrugëzgjidhje problemeve të shumta që ka ky sektor. Të shpresojmë që dialogimi të konkretizohet nga Bashkia, për realizime praktike efektive.

Z.Servet Feka:- (Antar i Këshillit Bashkiak)

-Përveç "pullave të sigurisë" të afishohen në subjektet e Biznesit të vogël edhe certifikatat e licensimit, të cilat përveç gjeneraliteteve të subjekteve përmbajnë fushën e aktivitetit tregtar dhe NIPT-in.

Këto probleme, ide, si dhe ky partneritet duhet të bëhet i njohur nga ne edhe në Këshillin Bashkiak, si një formë pasurimi e dhënie idesh konstruktive në dobi të qëllimit që po diskutojmë.

Z.Nonda Kajno:-(Kryetar i Shoqatës "Serenata korçare")

-Të rinjtë e talentuar duhen trajtuar e stimuluar nga Bashkia, mos ndodhë si me grupin e baletit të Joena Tabola që shkuan në emigracion në Itali dhe kanë sukses.

-Do të organizojmë spektaklin "Miss Korça 2008". Kemi filluar nga punë. Po kërkojmë elementë në universitet po duam dhe ndihmë.

Z.Ilia Dishnica:-(Drejtor ekzekutiv i Fondacioni "Dorkas")

-Ai foli për projektet e qëndrave shlodhëse për moshën e tretë, si ajo që ka krijuar Bashkia dhe që natyrisht është pak për një qytet të madh siç

tyre ashtu siç bëjnë universitetet e tjera të Shqipërisë, të Europës dhe të Botës, të cilët këtë elitë studentësh me prespektivë i mbajnë katedrat dhe fakultetet sipas përkatësisë, si asistentë, pedagogë me part-time ose permanentë, duke iu dhënë mundësinë që ata të kualifikohen, të punojnë, duke marrë master dhe tituj të tjerë shkencorë, duke zëvendësuar në të ardhmen ata pedagogë që nuk ecin me kërkesat bashkëkohore.

Një vendim i nxjerrë nga rektorati këtë vit që është sa i pa bazë, aq dhe kontradiktor me demagogjinë e përdorur në fillim të vitit dhe në fushatën zgjedhore për stimulimin e studentëve që do dalin me rezultate shumë të mira, duke mos i stimuluar këta studentë me pretekstin, se duhet të kenë 5 vjet stazh pune!?!.....

\*\*\*

Këshilli i Ideve zgjodhi në bazë të rotacionit grupin organizativ të punës për mbledhjen në muajin dhjetor të Këshillit të Ideve:

- 1.Ereandra Taipllari
- 2.Mariela Simo
- 3.Arben Kosturi

\*\*\*

Mbledhja e Këshillit të Ideve u karakterizua nga ide racionale dhe efektive, nga një frymë dialogu e debati konstruktiv për të gjetur projekte sa me bashkëkohore dhe që kanë të bëjnë me specifikën e qytetit të Korçës.

Laura Furxhi

**-ARZH-Korçë****-KONKURS-****-CIPE-**

Për Ju të rinj nga mosha 18 vjeç-30 vjeç një Ofertë interesante krijuese.

**-ESE-**Tematika orientuese:-Angazhimi i të rinjve në reformë-Kategoritë e temave-Qytetarët në Shqipërinë demokratike**-Reforma arsimore dhe mundësitë për punësim-Sipërmarrja dhe lidhshipi-Afati i dorëzimit deri më 20 janar 2009****-3 ESE-të më të mira do të marrin këto çmime:-Çmimi i parë: 500 \$, Çmimi i dytë: 300 \$, Çmimi i tretë: 200\$****-Vlerësimi do të bëhet nga Komisioni i Këshillit të Ideve Vini re: Ese-të do të dorëzohen në këtë**

Adresë: ARZH-Korçë

Rr."Ismail Qemali", Qendra e Biznesit, pranë Hotel "Grand"-kati i dytë, Tel: 00355 82 42626, Fax: 00355 82 53977,

e-mail:rdakorca@yahoo.com, Web: www.rda-korca.org

3 Esetë fituese do të dërgohen pranë qendrës për sipërmarrje ndërkombëtare private (CIPE), për të konkuruar sipas undhëzimit të mëposhtëm.

**QËNDRA PËR SIPËRMARRJE NDËRKOMBËTARE PRIVATE (CIPE)****Konkursi ndërkombëtar CIPE 2009 për esetë****Tema: Angazhimi i të rinjve në reformë**

Afati për konkursin 2009 është data 1 Mars 2009! Të rinjtë mund të jenë një forcë e madhe për ndryshim! Si reformatore të ardhshëm, të rinjtë (18-30) sjellin ide të reja se si të zgjidhen problemet politike, ekonomike dhe sociale që hasin vendet e tyre.

Megjithatë, ata shpesh kanë mangësi në sjelljen e këtyre ideve tek hartuesit e politikave. Thjesht, të rinjtë shpesh konsiderohen si marrësit e reformave, jo pjesëmarrës aktivë në procesin e reformave. Konkursi CIPE mbi esetë ju jep mundësinë të ndani idetë tuaja rreth qytetarisë, reformës demokratike dhe të orientuar nga tregu, lidhshipi të të rinjve dhe mënyrat se si vendi juaj mund të krijohet rrugë për të rinjtë që të marrin pjesë në sferat politike dhe ekonomike. Ne ju nxitim të mendoni, të përfshiheni dhe të përdorni eksperiencat tuaja në gjetjen e zgjidhjeve konkrete për këto çështje zhvillimi.

**Do të jepet një çmim prej 1000 \$ për çdo ese fituese.**

**Udhëzime:**

Përshtatshmëria. Kjo është e hapur për studentët dhe profesionistët e rinj nga mosha 18-30 vjeç.

Rëndësi e veçantë do i jepet eseve që dërgohen nga qytetarë jashtë BE.

**Kategoritë e temave:**  
**-Qytetaria në Shoqërinë Demokratike**  
**Çfarë duhet bërë për të zhvilluar sensin e qytetarisë tek të rinjtë dhe për t'i ndihmuar ata të kryejnë rolin e tyre në një shoqëri demokratike?**

Reformat e vërteta ndodhin vetëm kur qytetarët marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e qeverisjes – kjo nuk mund të arrihet vetëm me protesta në vende publike. Të rinjtë janë një pjesë thelbësore e shoqërisë dhe pjesëmarrja e tyre në qeverisje është e nevojshme për t'u dhënë efekt reformave politike dhe ekonomike. Megjithatë, shumë prej tyre kanë mangësi aftësish dhe mundësish për të komunikuar me hartuesit e politikave dhe për t'u përfshirë në zhvillimin e vendit të tyre. Të rinjtë shpesh nuk përfshihen në procesin politik dhe shumë rrallë zhvillojnë sensin e tyre të qytetarisë kështu që është e rëndësishme të ngrihet një demokraci gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse. Për t'u bërë qytetarë aktivë në vendet e tyre, të rinjtë duhet të kenë aftësi të zhvillojnë idetë e tyre mbi reformat për të shprehur këto ide me mënyra konstruktive. **Çfarë do të thotë qytetari për ju? Si lidhen qytetaria dhe qeverisja e tyre? Si angazhohet vendi juaj dhe si aftëson të rinjtë të marrin pjesë në procesin e qeverisjes?** Sigurohuni të filloni esenë tuaj duke për-

shkruar situatën në vendin tuaj.  
**-Reforma arsimore dhe mundësitë për punësim**  
**Si mund ta reformoni sistemin arsimor në vendin tuaj me qëllim që të diplomuarit të kenë aftësitë e duhura për t'u punësuar në sektorët publikë dhe privatë?**

Në shumë shtete, norma e papunësisë tek të rinjtë është shumë e lartë. Në shumë vende, kjo shkaktohet nga mungesa e vendeve të punës. Megjithatë, në vende të tjera, të rinjtë që hyjnë në punë nuk janë të përgatitur për punët që kanë në dispozicion – ata kanë mangësi në aftësi dhe edukim. Të paaftë për të gjetur një punë të mirë, ata hasin një zgjedhje të vështirë: të mbeten pa punë apo të pranojnë punë me pagë të ulët dhe pa mundësi për të përparuar më tej. Përmirësimi i sistemeve arsimore në shumë vende është një hap kyç drejt krijimit të një brezi të rinjsh të cilët të jenë të pajisur me aftësi dhe njohuri për të marrë pjesë në ekonomi, lokalisht dhe globalisht. **Cilat janë problemet më të mëdha të punësimit që hasin të rinjtë në vendin tuaj? Çfarë duhet bërë për t'u dhënë atyre aftësitë e duhura për të hyrë në fuqinë punëtore? Kush duhet të marrë drejtimin e kësaj?** Sigurohuni të filloni esenë tuaj duke përshkruar situatën në vendin tuaj.

**-Sipërmarrja dhe Lidhshipi**  
**Çfarë duhet bërë në vendin tuaj për t'u siguruar të rinjve mundësinë për t'u bërë sipërmarrës dhe/ose lidera në komunitetin e tyre?**

Të rinjtë mund të luajnë një rol pozitiv në sferat politike dhe ekonomike në vendet e tyre në nivele lokale dhe kombëtare. Për fat të keq, ata shpesh kanë mangësi në aksesin e burimeve dhe grupeve që do i ndihmonin ata të përfshiheshin dhe të ushtronin ndikim. Megjithatë, sapo të jenë të pajisur me mundësi dhe aftësi për t'u bërë anëtarë me influencë në komunitet, të rinjtë mund të përmbushin qëllimet e tyre. **Cilat janë aftësitë që të rinjtë duhet të përfitojnë për të filluar një biznes të suksesshëm ose një grup shoqërie civile? Cilat janë pengesat më të mëdha që i pengojnë ata të hapin një biznes ose të ndërmarrin pozicionin e liderit në vendin tuaj? Cilat programe ose politika do të aftësonin të rinjtë të bëhen aktivë dhe anëtare me influencë të shoqërisë?** Sigurohuni të filloni esenë tuaj duke përshkruar situatën në vendin tuaj.

**Esetë fituese**  
Në secilën kategori, do të zgjidhet një fitues i parë, i dytë dhe i tretë nga paneli i stafit të CIPE dhe partne-

rëve ndërkombëtarë. Tre esetë fituese nga secila kategori do të publikohen si artikuj të Shërbimit të Reformës Ekonomike. CIPE do të sigurojë secilin prej 9 fituesve me një çmim prej 1000 \$.

Esetë e tjera me vlerë mund të konsiderohen për publikim. CIPE mund të përkthejë disa artikuj në gjuhë të tjera, duke përfshirë arabisht, rusisht, spanjisht ose frëngjisht.

**Kriteret e vlerësimit**  
Esetë do të vlerësohen në mënyrë të qartë, origjinale dhe do të gjykohej kontributi i tyre për të kuptuar çështjet e zhvillimit që hasin vendet. Logjika e ideve të shprehura është më e rëndësishme sesa gramatika e mirë e anglishtes.

**Vlerësuesit:**  
Esetë do të vlerësohen nga një panel vlerësuesish që përfshijnë stafin e CIPE dhe partnerët ndërkombëtarë të saj.

**Rreth CIPE**  
Qendra për Sipërmarrje Ndërkombëtare Private është një degë jo-fitimprurëse e Dhomës Amerikane të Tregëtisë dhe një nga katër institucionet e rëndësishme të Ndihmës Kombëtare për Demokraci. CIPE ka mbështetur më shumë se 1000 iniciativa lokale në më shumë se 100 vende në zhvillim, duke përfshirë sektorin privat në mbrojtjen e politikave dhe reformave institucionale, në

përmirësimin e qeverisjes dhe ngritjen e ndërgjegjësimit mbi sistemet demokratike të bazuara në treg.

CIPE deklaron se vendet duhet të ngrejë njëkohësisht institucione të orientuara nga tregu dhe ato demokratike duke qenë se ato janë dy anët e të njëjtës monedhë. Pa një sistem funksional tregu, demokracitë do të mbeten të dobta. Po kështu, pa një proces demokratik, reformat ekonomike nuk kanë mundësi të ecin përpara.

**Formati dhe udhëzimet për konkursin**

-Të gjitha esetë duhet të shkruhen në anglisht;  
-Të gjitha esetë duhet të jenë origjinale dhe të publikuara;  
-Nuk do të pranohen punët e përbashkëta;  
-Numri i fjalëve: 2000 – 4000;  
-Të tregohet kategoria e esesë në faqen e parë;  
-Të sigurohet informacioni plotë kontakti në faqen e parë duke përfshirë edhe shtetësinë.

**Koha në dispozicion**  
Të gjitha esetë duhet të dërgohen deri në 1 Mars 2009.

**Si të dërgohen**  
-Dërgoni me e-mail një kopje të esesë si dokument lokal në më shumë se 100 më programin MS-Word në [essay@cipe.org](mailto:essay@cipe.org)  
-Do të dërgohet një e-mail konfirmues për marrjen e postimit.

## POLICIA BASHKIAKE NË AKSION PËR LUFTËN KUNDËR INFORMALITETIT (Intervistë me Drejtorin e Policisë bashkiake Korçë z.Enver Shahinasi)



**P y e t j e : - Ç f a r ë P ë r g j i g j e : -** Ndër funksione ka Policia bashkiake sipas ligjit?

**P ë r g j i g j e : -** Objekti kryesor i Policisë Bashkiake është zbatimi i urdhërave të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të Ardhurave të Bashkisë. Në qytet, luftën kundër informalitetit, kundër ushqimor dhe industrial ndërrhyrjes së paligjshme në prona publike, zënie rruge, masave të mara nga trotuare, dëmtimi i tyre, bashkëpunim me rajonet administrative, për zgjidhjen e konflikteve midis qytetarve, mbirruajtjen e qetësisë publike, etj.

**P y e t j e : -** Gjatë ushtrimit të kontrollit tuaj deri në nëntor të vitit 2008, çfarë keni konstatuar dhe çmasa keni marrë?

**P y e t j e : -** Gjatë ushtrimit të kontrollit tuaj deri në nëntor të vitit 2008, çfarë keni konstatuar dhe çmasa keni marrë?

Këshilli Bashkiak ka kusht që të bëhet “lojra e fatit”, në marrë një vendim për izolimi zonor i ambienteve në qytet të karrocave, si dhe tregun industrial dhe mos lejimin në qytet të qetësinë publike. Në Pamvarësisht se është gtimin e fermerëve nëpër stinën e verës një fundi i vitit një numër i trotuarë. Vërejmë me rëndësi të veçantë i konsiderueshëm i këkënaqësi, se në bazë të kushtuam rregullit në tyre subjekteve është punës së bërë dhe “Parkun Rinia”, si dhe në proces liçensimi. Për vitin 2009 objektivi subjekteve ambulante për 24 orë për “Festën ynë dhe i Drejtorisë së dhe fermerëve, nuk kemi e Birës” dhe atë të të Ardhurave në bashkëpunim dhe me më vozitje karrocash karnavaleve dhe po shkëpunim dhe me nëpër qytet, si dhe përgatitemi për Krishli-Shoqatën e Biznesit të tregtim nëpër trotuare. ndjen dhe Vitin e Ri Vogël është që subjekteve të Biznesit të tregtim nëpër trotuare. Ne po punojmë për 2009, në mënyrë që subjekteve të Biznesit të tregtim nëpër trotuare. Ne po punojmë për 2009, në mënyrë që subjekteve të Biznesit të tregtim nëpër trotuare. Ne po punojmë për 2009, në mënyrë që subjekteve të Biznesit të tregtim nëpër trotuare.

**P y e t j e : - S i p a s** ndershme. Sipas ndryshimeve të fundit në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Policia Bashkiake merr kope-tenca në zbatim të rregullave të Qarkullimit Rrugor në qytet. Në këtë kuadër dhe me interesimin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë Z.Niko Peleshi është pregatitur infrastruktura e nevojshme për këtë qëllim dhe gjatë vitit 2009 do të punohet me intensitet të plotë duke caktuar

**P ë r g j i g j e : -** Gjatë izolimin zonor të këtyre dy javëve të ambienteve në lokalet e fundit të muajit nëntor nga Policia Bashkiake janë vënë 40 gjoba, me një vlerë 120 mijë lek të reja.

Puna jonë është të kësaj natyre që trajtojmë në këtë periudhë në subjektet e

me shërbim një patrullë e Policisë Bashkiake në qytet për të zbatuar rregullat e qarkullimit rrugor, mosparkim kundër tabelave, mosparkim në stacionet e autobusave, urbanë, kontenierët e mbeturinave urbane, në vendet e parkimit të taksive. Prioritare do të jetë kontrolli i subjekteve të taksive që punojnë të palicensuar në qytet.

Ne jemi të bindur se i kemi të gjitha mundësitë, duke u bazuar dhe te kultura qytetare korçare ta bëjmë Korçën qytet model, i tregëtisë së lirë, të liçensuar, i konkurrencës së ndershme, rregullit dhe qetësisë publike, respektimit të gjithë urdhërave që nxjerr Këshilli Bashkiak dhe Bashkia Korçë. -Ju faleminderit!

**Intervistoi:**  
**Ervin Cepa**



**A.R.ZH. - Korçë**

(Agjensia Rajonale e Zhvillimit-korçë)

Adresa:

Rr. „Ismail Qemali“-

Qendra e Biznesit

pranë Hotel „Grand“, kati i dytë

Tel.: 00355 82 42626

Fax: 00355 82 53977

e-mail: rdakorca@yahoo.com

Web: www.rda-korca.org

- në bashkëpunim me -

**Gazeta „KORÇA“**

(Suplement)

Adresa:

Rr. „Misto Mame“ Nr.13 Korçë

Tel & Fax: 00355 82 42985

Tel: 00355 82 52460

Cel: 00355 682459546

e-mail: gazetakorca@yahoo.co.uk

**PËRGATITI:**

Art Design:

Laura Furxhi

Shtyp „KOTIT“